

LIGJ
Nr. 28/2015

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA
E FINANCIVE, DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, SI
ADMINISTRATOR PËR FONDET E GRANTEVE, PËR NDËRTIMIN E
KAPACITETEVE PËR KONCESIONET PËR INVESTIMET
NË ENERGJI DHE INDUSTRI**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si administrator për fondet e granteve, për ndërtimin e kapaciteteve për koncesionet për investimet në energji dhe industri, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 26.3.2015

**Shpallur me dekreten nr. 9044, datë 10.4.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

Marrëveshje Granti nr. C29314/NONC-2010-12-04

MARRËVESHJE GRANTI

Për Shqipërinë: Ndërtimi i Kapaciteteve për Koncesionet për Investimet në Energji dhe Industri në Shqipëri, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim si Administratore për Fondet e Granteve të dhëna nga Fondi i Ri i Bashkëpunimit me Norvegjinë

MARRËVESHJE GRANTI

Marrëveshja e Grantit nr. C29314/NONC-2010-12-04, datë ... ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave (Përfituesi) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka ose BERZH) me selinë e saj tek One Exchange Square, London EC2A 2JN, Mbretëria e Bashkuar, një institucion ndërkombëtar financiar i krijuar sipas Marrëveshjes Themeluese të Bankës, të nënshkruar në Paris, më 29 maj 1990, që vepron si administratore e fondeve të grantit që gjenden në Fondin e Ri të Bashkëpunimit me Norvegjinë, të dhënë nga Qeveria e Norvegjisë (Donatori).

PREAMBULË

Duke marrë në konsideratë se Bankës i është kërkuar të shqyrtojë ofrimin e bashkëpunimit teknik për Përfituesin në formën e shërbimeve të konsulencës së financimit për ofrimin e Ndërtimit të Kapacitetit për Koncesionet për Investimet në Energji dhe Industri në Shqipëri (“Projekti”, “Shqipëri: Ndërtimi i Kapaciteteve për Koncesionet për Investimet në Energji dhe Industri”), ku asistenca teknike ofrohet për ndërtimin e kapaciteteve për të eliminuar barrierat dhe nxitur investimet në energjinë e rinovueshme në Shqipëri (Shërbimet),

duke marrë në konsideratë se Ministria e Energjisë dhe Industrisë (Ministria e Energjisë dhe Industrisë) duhet të prokurojë një konsulent (Konsulent) në pajtim me politikat dhe rregullat e prokurimit dhe rregullat e tjera të BERZH-it,

duke marrë në konsideratë se Ministria e Energjisë dhe Industrisë lidh një Kontratë Konsulence për dhënien e shërbimeve me Konsulentin (Kontrata e Konsulencës) në kufirin tavan prej 636,634.00 eurosh,

duke marrë në konsideratë se në pajtim me Marrëveshjen e Fondit të Bashkëpunimit Teknik ndërmjet Donatorit dhe Bankës, Donatori ka aprovuar dhe ka rënë dakord të ofrojë fonde deri në 636,634.00 euro, mbi bazë granti (Granti) për të financuar shërbimet e një Konsulenti me termat dhe kushtet e parashikuarmë poshtë,

duke marrë në konsideratë se Përfituesi do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme në pajtim me ligjin shqiptar për t’i ofruar Grantin Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, nëpërmjet një marrëveshjeje transferimi për qëllimin e specifikuar në termat dhe kushtet e parashikuara në këtë Marrëveshje,

duke marrë në konsideratë se Përfituesi do të garantojë si kusht për marrjen e Grantit që, duke njohur marrjen e përfitimeve të shërbimeve, Ministria e Energjisë dhe Industrisë do të respektojë të gjitha detyrimet kontraktuale të shprehura në këtë Marrëveshje Granti si të jenë të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë;

duke marrë në konsideratë se Banka ka rënë dakord të administrojë Grantin sipas termave dhe kushteve të përcaktuara,

kështu palët bien dakord për termat specifike të mëposhtëm:

Neni 1

Përkufizime

1.01 Përkufizimet dhe interpretimi

Kurdoherë që përdoren në këtë Marrëveshje, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm me germa kapitale kanë kuptimet eaktuara më poshtë:

- a) “Kostoja e Porosive” është kostoja për shërbimet;
- b) “Banka” ose “BERZH-i” është Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim;
- c) “Ministria e Energjisë dhe Industrisë” është Ministria e Energjisë dhe Industrisë, pala së cilës do t’i jepen shërbimet sipas Kontratës së Konsulencës;
- d) “Angazhimi i Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë” është kontributi financiar që Ministria e Energjisë dhe Industrisë do të japë kundrejt kostonë së dhënies së shërbimeve;
- e) “Konsulent” është pala e cila do të kryejë shërbimet;
- f) “Kontrata e Konsulencës” është marrëveshja që lidhet ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe Konsulentit për kryerjen e shërbimeve;
- g) “Vendi i Porosisë” është Shqipëria;
- h) “Donatori” është dhënësi i fondeve të Grantit, siç specifikohet në preambulën e kësaj Marrëveshjeje;
- i) “Granti” është shuma e fondeve që i ofrohen Bankës nga Donatori, si administratore për qëllimin e financimit të Kontratës së Konsulencës;

j) “Marrëveshje Granti” është Marrëveshja dhe të gjitha shtojcat e bashkëlidhura, e cila mund të ndryshohet herë pas here;

k) “Shuma Maksimale e Kontratës” është shuma maksimale deri në 636,634.00 euro që duhet t’i paguhet Konsulentit sipas një kontrate konsulence, duke përfshirë të gjitha tarifat, dietat dhe shpenzimet;

l) “Drejtuesi i Operacionit” është anëtari i personelit të Bankës, përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Kontratës së Konsulencës në emër të Bankës;

m) “Përfituesi” është Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave;

n) “Shërbimet” janë shërbimet që kryhen nga Konsulenti për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë sipas parashikimit në Kontratën e Konsulencës.

1.02 Interpretimi

a) Titujt në këtë Marrëveshje janë vetëm për lehtësi dhe nuk ndikojnë në interpretimin e saj.

b) Në këtë Marrëveshje, referenca të një akt është referencë të ky akt dhe të rregulloret e bëra në pajtim me këtë akt dhe ky akt dhe rregulloret mund të ndryshohen ose modifikohen herë pas here dhe mbeten në fuqi dhe të çdo akt dhe rregullore që mund të miratohen dhe kanë fuqinë e plotësimit ose zëvendësimit të këtij akti dhe rregulloreve.

c) Në këtë Marrëveshje, një referencë të një gjini përfshin një referencë të të gjitha gjinitë e tjera, numri njëjës përfshin shumësin dhe anasjellas, ndërsa referencat të personat përfshijnë organizatat e regjistruara, të paregjis-truara dhe partneritetet. Referenca të një person përfshin pasuesit dhe drejtëmarrësit e lejuar.

Neni 2

Granti

2.01 Granti

a) Banka bie dakord t’i ofrojë Përfituesit, sipas termave dhe kushteve të parashikuar në këtë Marrëveshje, Grantin në një shumë që nuk kalon 636,634.00 euro ose ekuivalentin e saj.

b) Granti do të përdoret vetëm për të financuar shërbimet gjatë afatit të angazhimit të Konsulentit.

2.02 Disbursimi

a) Përfituesi dhe Banka bien dakord që Banka autorizohet të kryejë disbursime drejtpërdrejt te Konsulenti, në emër të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

b) Shuma e Grantit do të livrohët nga Banka drejtpërdrejt te Konsulenti, në emër të dhe sipas udhëzimeve të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, në pajtim me dispozitat e Kontratës së Konsulencës.

c) Me marrjen e një fature dhe të dokumenteve mbështetëse nga Konsulenti, të paraqitura në pajtim me dispozitat e Kontratës së Konsulencës, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, pa vonesë, kontrollon dhe verifikon faturën dhe përmbushjen e arsyeshme të atyre shërbimeve të Konsulentit me të cilat lidhet fatura.

d) Nëse ato shërbime konstatohen të jenë të pranueshme dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë është e bindur se shumat e caktuara në faturë përputhen me shumat e parashikuara në Kontratën e Konsulencës, fatura, dokumentet mbështetëse dhe një pasqyrë (siç përcaktohet në shtojcën A të Marrëveshjes së Grantit), që certifikon aprovimin e shërbimeve, duhet t’i kalohet Bankës për pagesë në Zyrën e Rezidentit të Bankës në Tiranë, godina “Torre Drin”, kati 4-t, rruga “Abdi Toptani,” Tiranë, Shqipëri.

2.03 Taksat dhe detyrimet

a) Ministria e Energjisë dhe Industrisë bie dakord që fondet e Grantit të mos përdoren për të financuar tatimet jo të drejtpërdrejta (duke përfshirë TVSH-në) në lidhje me shërbimet e kësaj

Marrëveshjeje Granti, të vendosura sipas ligjeve dhe rregulloreve që janë në fuqi në vendin e porosisë.

b) Ministria e Energjisë dhe Industrisë njofton Bankën nëse taksa jo të drejtpërdrejta (duke përfshirë TVSH-në) janë të kërkueshme në lidhje me Kontratën e Konsulencës.

c) Ministria e Energjisë dhe Industrisë bie dakord që çdo taksë jo e drejtpërdrejtë (duke përfshirë TVSH-në) e pagueshme, t'i paguhet Konsulentit nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

d) Nëse është e kërkueshme një taksë jo e drejtpërdrejtë (duke përfshirë TVSH-në), në kohën e dhënies së certifikatës Bankës sipas dispozitës 2.02(d), Ministria e Energjisë dhe Industrisë vërteton, gjithashtu, pagesën prej saj të taksave jo të drejtpërdrejta (duke përfshirë TVSH-në) të pagueshme për çdo faturë të mëparshme të Konsulentit dhe merr përsipër të paguajë taksën jo të drejtpërdrejtë (duke përfshirë TVSH-në) për këtë faturë.

e) Mospagimi nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë e ndonjë takse jo të drejtpërdrejtë (duke përfshirë TVSH-në) mund të rezultojë në përfundimin e kësaj Marrëveshjeje në pajtim me dispozitën 5.03.

Neni 3

Ekzekutimi i Projektit

3.01 Bashkëpunimi dhe informacioni

a) Banka dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë bashkëpunojnë plotësisht në lidhje me administrimin e Kontratës së Konsulencës.

Banka, Përfutuesi dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë, herë pas here dhe me kërkesë të një prej tyre, shkëmbejnë mendime në lidhje me përparimin e Projektit, shërbimeve, qëllimeve për të cilat jepet Granti, përmbushjen e detyrimeve të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë sipas kësaj Marrëveshjeje, dhe përmbushjen e detyrimeve të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe Konsulentit, sipas Kontratës së Konsulencës dhe i japin palës tjetër të gjithë informacionin përkatës që pala tjetër mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme.

b) Ministria e Energjisë dhe Industrisë njofton menjëherë Bankën për çdo ndryshim të propozuar në natyrën ose objektin e Projektit, shërbimeve ose punës apo operacioneve të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë ose çdo ngjarje ose kushti tjetër që mund të ndikojë në mënyrë të konsiderueshme në përmbushjen e Projektit ose shërbimeve, ose kryerjen e aktivitetit apo operacioneve të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

c) Pa cenuar përgjithësimin e sa më sipër, Ministria e Energjisë dhe Industrisë nuk kryen asnjë ndryshim të konsiderueshëm, duke përfshirë vendimin në lidhje me porositë dhe nënkontraktimin, në Kontratën e Konsulencës pa marrë pëlqimin paraprak me shkrim nga Banka dhe ky pëlqim nuk refuzohet në mënyrë të paarsyeshme. Në çdo rast, të gjitha ndryshimet e Kontratës së Konsulencës i njoftohen Bankës nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

3.02 Regjistrat dhe raportet

a) Ministria e Energjisë dhe Industrisë:

i) mban në fuqi procedura dhe regjistra të përshtatshëm për të regjistruar dhe monitoruar progresin e shërbimeve (duke përfshirë koston e tyre dhe përfitimet që rrjedhin prej tyre) dhe për të identifikuar shërbimet e financuara nga shumat e Grantit dhe do t'ua ofrojë këta regjistra përfaqësuesve të Bankës me kërkesë të Bankës;

ii) mban llogari dhe pasqyra financiare (balance, pasqyra të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe pasqyra mbështetëse) të nevojshme për të monitoruar dhe regjistruar progresin e shërbimeve, duke përfshirë koston dhe përfitimet e përfutuara prej këtyre shërbimeve, dhe për t'i dhënë Bankës, me kërkesë, kopje të këtij informacioni dhe me detaje që Banka i kërkon në mënyrë të arsyeshme;

iii) u jep mundësi përfaqësuesve të Bankës, me kërkesë të Bankës, të vizitojnë çdo mjedis të

përfshirë ose të përmendur në Projektin ose Kontratën e Konsulencës dhe të shqyrtojnë shërbimet e financuara nga shumat e Grantit dhe çdo fabrikë, instalim, kantier, punë, ndërtesa, prona, pajisje, regjistra dhe dokumente që lidhen me përmbushjen e detyrimeve të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë ose Konsulentit, sipas kësaj Marrëveshjeje ose Kontratës së Konsulencës;

iv) i jep përfaqësuesit të Bankës të gjithë informacionin që Banka kërkon, në mënyrë të arsyeshme në lidhje me Projektin dhe shërbimet, koston e tyre dhe, sipas rastit, përfitimet që nxirren prej tyre dhe shpenzimet e shumave të Grantit;

v) u ofron ose merr masa për t'u ofruar përfaqësuesve të Bankës menjëherë pas përgatitjes së tyre të të gjitha planeve, speci-fikimeve, raporteve, kontratave, dokumenteve (duke përfshirë artikujt sipas Kontratës së Konsulencës) dhe çdo modifikim material të saj ose shtesë, me ato hollësi që Banka kërkon në mënyrë të arsyeshme;

b) Menjëherë pas përfundimit të shërbimeve, Ministria e Energjisë dhe Industrisë përgatit dhe i jep Bankës një raport në gjuhën e specifikuar, me atë objekt dhe hollësi që Banka kërkon në mënyrë të arsyeshme, mbi ekzekutimin dhe operimin e shërbimeve, koston dhe përfitimet e nxjerra ose që do të nxirren prej tyre dhe punën e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Konsulentit dhe Bankës të detyrimeve të tyre përkatëse sipas Marrëveshjes së Grantit dhe Kontratës së Konsulencës, sipas rastit.

c) Të gjithë raportet dhe regjistrat e përgatitur nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë përpilohen në formatin Microsoft Word dhe/ose Excel, të përputhshme me formatin Acrobat dhe jepen në format elektronik dhe në letër.

3.03 Konfidencialiteti

Përveçse me pëlqimin paraprak me shkrim të Bankës, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Përfituesi nuk deklarojnë apo bëjnë apo lejojnë që agjentët ose nënkontraktorët e tyre të deklarojnë kundrejt palëve të treta apo të përdorin për qëllimet e tyre ndonjë informacion në lidhje me shërbimet, Projektin ose Bankën, duke përfshirë informacionin në lidhje me Kontratën e Konsulencës. Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Përfituesi mund t'i japin këto të dhëna dhe informacione nëse kërkohet me ligj apo rregullore të zbatueshme, por vetëm atë pjesë të informacionit që në masën e lejuar nga ligji përkatës apo kërkesa rregullatore, të jetë e kërkuar ligjërisht për t'u dhënë. Nëse bëhet një kërkesë e tillë, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Përfituesi njoftojnë menjëherë Bankën.

3.04 Kryerja e operacioneve

Përveç kur Banka bie dakord ndryshe, Ministria e Energjisë dhe Industrisë e zhvillon aktivitetin dhe operacionet e veta (duke përfshirë operacionet e një filiali) në pajtim me standardet dhe praktikatat e qëndrueshme administrative, teknike, financiare dhe mjedisore të njohura ndërkombëtarisht nën mbikëqyrjen e menaxhimit të kualifikuar dhe me përvojë të asistuar nga personeli kompetent në shifra të përshtatshme.

3.05 Mbështetja e Përfituesit

Përfituesi:

i) përmbush rregullisht të gjitha detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje;

ii) mbështet Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë marrjen e të gjitha masave të nevojshme apo të dëshirueshme legjislative, rregullatore apo të tjera, dhe duke caktuar dhe ofruar apo duke marrë masa për të ofruar fonde dhe mbështetje për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë në kohën e duhur nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë për të përfunduar Projektin; dhe

iii) merr çdo masë, sipas ligjit shqiptar, të nevojshëm për t'i dhënë fuqi kësaj Marrëveshjeje.

4.01 Përfaqësuesi i Autorizuar

Çdo veprim i kërkuar apo i lejuar për t'u ndërmarrë dhe çdo dokument i kërkuar apo i lejuar për t'u nënshkruar sipas kësaj Marrëveshjeje kryhet ose nënshkruhet:

- a) në emër të Përfituesit, ministri i Financave;
- b) në emër të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë; dhe
- c) në emër të Bankës nga drejtori, Bashkëpunimi Teknik ose një përfaqësues i auto-rizuar i Bankës.

4.02 Njoftimet ose kërkesat

Çdo njoftim, kërkesë ose pëlqim që kërkohet ose lejohet të kryhet në pajtim me këtë Marrëveshje bëhet me shkrim në gjuhën angleze. Çdo njoftim, kërkesë ose pëlqim i tillë konsiderohet të jetë dhënë ose bërë nëse dorëzohet personalisht te një përfaqësues i autorizuar i palës së cilës i drejtohet komunikimi ose kur i dërgohet me postë të regjistruar apo faks kësaj Pale në adresën e mëposhtme:

Për Përfituesin:	Në vëmendje të:	Z. Shkëlqim Cani Ministër i Financave
	Adresa:	Ministria e Financave Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Tiranë, Shqipëri
	Tel.	+355 4 223 4647
	Faks:	+355 4 222 8494
Për Përfituesin e Grantit:	Në vëmendje të:	Z. Damian Gjiku Ministër i Energjisë dhe Industrisë
		Ministria e Energjisë dhe Industrisë Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", 1001 Tiranë, Shqipëri
	Tel.	+355 4 222 2245
	Faks:	+355 4 223 4052
Për Bankën:	Në vëmendje të:	Raphael Rashid, "Drejtuuesi i Operacioneve"
	Adresa:	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim One Exchange Square London EC2A 2JN, UK
	Tel.	+ 44 20 7338 6581
	E-mail:	rashidr@ebrd.com

- a) Njoftimi konsiderohet të jetë kryer si më poshtë:

- i) në rastin e dorëzimit dorazi ose me postë të regjistruar, në momentin e dorëzimit; dhe
- ii) në rastin e faksit, pas transmetimit të konfirmuar.

B) Një palë mund ta ndryshojë adresën e saj për kryerjen e njoftimeve ose kërkesave, duke i bërë palës tjetër njoftim të arsyeshëm sipas kësaj dispozite.

Neni 5

Pezullimi dhe përfundimi

5.01 Njoftimi i Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë

Ministria e Energjisë dhe Industrisë njofton menjëherë Bankën për pezullimin ose prishjen e Kontratës së Konsulencës ose për çdo ngjarje që mund të çojë në pezullimin ose prishjen e Kontratës së Konsulencës.

5.02 Pezullimi i livrimeve

Nëse një prej ngjarjeve të mëposhtme ka ndodhur dhe vazhdon, Banka, duke njoftuar me shkrim Përfituesin pezullon pjesërisht ose plotësisht livrimet e kërkueshme pas kësaj nga Konsulenti, në pajtim me termat e kësaj Marrëveshjeje:

a) Kontrata e Konsulencës është pezulluar ose përfunduar në pajtim me termat e Kontratës së Konsulencës;

b) Ministria e Energjisë dhe Industrisë nuk u ka paguar Konsulentëve pjesën e tatimeve jo të drejtpërdrejta (duke përfshirë TVSH-në) për faturat e Konsulentëve në kohën e duhur në pajtim me termat e Kontratës së Konsulencës;

c) Ka ndodhur një kusht tjetër, i cili, sipas mendimit të arsyeshëm të Bankës, ndërhyrje ose rrezikon të ndërhyjë në kryerjen e suksesshme të shërbimeve ose Projektit, ose arritjen e qëllimeve të kësaj Marrëveshjeje.

5.03 Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje nga Banka

a) Banka, nëpërmjet njoftimit me shkrim drejtuar Përfituesit, mund ta përfundojë këtë Marrëveshje, nëse:

i) një prej kushteve të përmendura në dispozitën 5.02 vazhdon për një periudhë prej tridhjetë (30) ditësh pasi Banka të ketë pezulluar plotësisht ose pjesërisht livrimet që kërkohen nga Konsulenti dhe për këtë i ka bërë njoftim me shkrim Përfituesit; ose

ii) Kontrata e Konsulencës ka skaduar ose ka përfunduar në pajtim me termat e saj; ose

iii) Përfituesi dhe Banka bien dakord ta përfundojnë në pajtim me termat e kësaj Marrëveshjeje; ose

iv) Donatori anulon financimin e Grantit; ose

v) prokurimi i një prej shërbimeve nuk është në pajtim me këtë Marrëveshje; ose

vi) fondet e livruara sipas kësaj Marrëveshjeje, janë përdorur për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara sipas kësaj Marrëveshjeje.

b) Në çdo rast, Banka mund ta përfundojë këtë Marrëveshje në çdo kohë, duke i bërë Përfituesit një njoftim jo më pak se dyzet ditë para.

5.04 Procedura e prishjes

Pas prishjes së kësaj Marrëveshjeje, në pajtim me dispozitën 5.03, Ministria e Energjisë dhe Industrisë merr masa të menjëhershme për të ulur humbjet dhe për t'i mbajtur shpenzimet e tjera sipas Kontratës së Konsulencës në një nivel minimal.

Neni 6

Të përgjithshme

6.01 Përjashtimi i përgjegjësisë

Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje, Banka nuk i detyrohet Përfituesit, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë ose Konsulentit sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje apo Kontratën e Konsulencës për asnjë humbje apo dëm, qoftë i shkaktuar nga veprimi ose mosveprimi neglizhent i Bankës. Kjo dispozitë nuk zbatohet për asnjë veprim apo mosveprim neglizhent të Bankës, i cili shkakton vdekjen, dëmtim personal të personelit të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Konsulentit apo Ekspertëve.

6.02 Zhdëmtimi

Ministria e Energjisë dhe Industrisë zhdëmton dhe, sipas privilegjeve dhe imuniteteve të Bankës, mbron Bankën, drejtorët, nëpunësit, punonjësit, agentët dhe kontraktorët e saj ndaj të gjitha pretendimeve, dëmeve, kostove, shpenzimeve, detyrimeve, gjykimeve, humbjeve që rrjedhin nga ose në lidhje me një veprim apo mosveprim, qoftë me dashje, neglizhent apo tjetër, të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë ose konsulentit, punonjësve të tyre, nënkontraktorëve ose agentëve apo me një shkelje prej tyre të detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje, Kontratës së Konsulencës ose mosrespektimit prej tyre të një akti, rregulli ose rregulloreje.

6.03 Praktika e ndaluar

Banka, pavarësisht ndonjë mjeti tjetër ndaj shkeljes së Marrëveshjes, mund ta prishë këtë Marrëveshje menjëherë nëse Përfituesi, dhe/ose Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në gjykimin e Bankës, është përfshirë në praktika të ndaluara në konkurrimin ose ekzekutimin e Kontratës së

Konsulencës.

“Praktikë korruptive” është ofrimi, dhënia, pranimi ose kërkimi, drejtpërdrejt ose jo, i një sendi me vlerë për të ndikuar në mënyrë të padrejtë te veprimet e një pale tjetër në lidhje me procesin e zgjedhjes ose ekzekutimin e Kontratës, me qëllim që të përftohet ose mbahet një biznes apo avantazh i parregullt në zhvillimin e biznesit.

“Praktikë mashtrimi” është çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqpërfaqësim, e cila çorienton ose përpiket të çorientojë, me dashje ose nga pakujdesia, një palë për të përfutur një përfitim financiar ose tjetër ose të shmangë një detyrim.

“Praktikë detyruese” është cenimi ose dëmtimi, ose kërcënimi për të cenuar apo dëmtuar, drejtpërdrejt ose jo, i një pale apo prone të palës për të ndikuar në mënyrë të padrejtë në veprimet e një pale tjetër në lidhje me procesin e zgjedhjes ose ekzekutimin e Kontratës, me qëllim që të përftohet ose mbahet një biznes apo një avantazh i parregullt në zhvillimin e biznesit.

“Praktikë e fshehtë” është një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve, e destinuar për të arritur një qëllim të padrejtë, duke përfshirë ndikimin e padrejtë të veprimeve të një pale tjetër që përfshin çdo marrëveshje ndërmjet konsulentëve (para ose pas paraqitjes së propozimeve), e destinuar për të caktuar çmimet në nivele jokonkurruese artificiale dhe për t'i hequr Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë avantazhet e konkurrencës së lirë dhe të hapur.

6.04 Inspektimi dhe auditimi nga Banka

Ministria e Energjisë dhe Industrisë i lejon Bankës ose përfaqësuesve të saj të autorizuar të inspektojnë llogaritë dhe regjistrat e tyre në lidhje me përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje, Kontratës së Konsulencës dhe shërbimeve, si dhe auditimin e këtyre llogarive nga auditët e caktuar nga Banka, nëse kjo kërkohet nga Banka.

6.05 Sigurimi E pazbatueshme.

6.06 Ligji rregullues dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

a) Kjo Marrëveshje interpretohet në pajtim me ligjin anglez. Çdo detyrim jokontraktual që rrjedh nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje rregullohet dhe interpretohet në pajtim me ligjin anglez.

b) Çdo mosmarrëveshje apo pretendim që rrjedh nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje apo shkelje, përfundim apo pavlefshmëri të saj apo çdo detyrim jokontraktual që rrjedh nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, e cila nuk mund të zgjidhet me pajtim, zgjidhet me arbitrazh në pajtim me Rregullat e Arbitrazhit UNICITRAL, që janë në fuqi në datën e kësaj Marrëveshjeje. Do të ketë një (1) arbitër dhe autoriteti emëruar për qëllimet e rregullave UNICITRAL do të jetë LCIA (Gjykata e Londrës për Arbitrazhin Ndërkombëtar). Selia dhe vendi i arbitrazhit është Londra, Angli, dhe gjuha angleze do të përdoret gjatë të gjithë gjykimit në arbitrazh. Palët heqin dorë nga çdo e drejtë sipas aktit të Arbitrazhit të vitit 1996 ose tjetër, për të ankimuar ndonjë vendim arbitrazhi apo për të kërkuar paraprakisht interpretimin e një çështjeje ligjore nga gjykatat e Anglisë apo në institucione të tjera të ngjashme. Arbitri nuk autorizohet të japë dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë bie dakord të mos kërkojë nga asnjë autoritet gjyqësor, ndonjë masë të përkohshme apo kompensim para vendimit ndaj Bankës, pavarësisht dispozitave të Rregullave të Arbitrazhit UNICITRAL.

c) Asgjë në këtë Marrëveshje nuk interpretohet si heqje dorë apo modifikim nga Banka i një imuniteti, privilegji apo përjashtimi të Bankës, të dhënë në pajtim me Marrëveshjen Themeluese të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, një konventë ndërkombëtare apo një ligj të zbatueshëm. Pavarësisht nga sa më sipër, Banka i është nënshtruar shprehimisht arbitrazhit sipas seksionit 6.06(b) të kësaj Marrëveshjeje dhe për pasojë, dhe pa cenuar privilegjet dhe imunitetet e saj (duke përfshirë, pa u kufizuar në paprekshmërinë e arkivave të saj), ajo njeh që nuk ka imunitet ndaj padisë dhe proceseve gjyqësore sipas nenit 5(2) të Instrumentit Statutor të vitit 1991, nr.757 (urdhri i Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim i vitit 1991) ose një dispozitë e ngjashme sipas ligjit

anglez, në lidhje me ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi që është dhënë rregullisht ndaj saj si rezultat i nënshtrimit shprehimisht ndaj arbitrazhit sipas seksionit 6.06(b) të kësaj Marrëveshjeje.

6.07 Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas përfundimit të procedurave të brendshme për hyrjen e saj në fuqi, sipas ligjit shqiptar dhe, përveç kur pezullohet apo përfundohet në pajtim me nenin 5, mbetet në fuqi të plotë derisa të jenë përfunduar shërbimet dhe të gjitha pagesat sipas Kontratës së Konsulencës.

6.08 Ndryshimi i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje, mund të ndryshohet me marrëveshje me shkrim ndërmjet Bankës dhe Përfituesit të nënshkruar rregullisht nga përfaqësuesit e autorizuar.

6.09 Tërësia e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje së bashku me shtojcat e saj, të ndryshuara herë pas here në pajtim me Dispozitën 6.08, përmban të gjithë mirëkuptimin dhe marrëveshjen ndërmjet palëve dhe pezullon të gjitha propozimet ose marrëveshjet e tjera në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshjeje. Asnjë palë nuk është mbështetur në ndonjë angazhim apo përfaqësim të bërë nga pala tjetër që nuk është kusht i kësaj Marrëveshjeje.

6.10 Pasuesit

Kjo Marrëveshje detyron dhe është në favor të pasuesve përkatës dhe drejtëmarrësve të lejuar të palëve në të.

6.11 Përfundimi i të drejtave të palëve të treta

Kjo Marrëveshje nuk krijon asnjë të drejtë sipas aktit të Kontratave (të drejtat e palëve të treta), të vitit 1999, të zbatueshme nga ndonjë person apo subjekt që nuk është palë në të, përveç personave apo subjekteve që janë pasues ose përfitues me cedim të të drejtave të një pale që konsiderohet të jetë palë në këtë Marrëveshje.

6.12 Mbetja në fuqi e dispozitave

Dispozitat 3.03, 6.01, 6.02, 6.03, 6.04 dhe 6.06 mbeten në fuqi pas përfundimit ose kalimit të afatit të kësaj Marrëveshjeje.

6.13 Gjuha

Anglishtja është gjuha e Marrëveshjes. Të gjitha komunikimet, dokumentacioni dhe raportet sipas kësaj Marrëveshjeje dhe Kontrata e Konsulencës përgatiten dhe paraqiten në gjuhën angleze.

6.14 Garanci të tjera

Ministria e Energjisë dhe Industrisë, vetë ose nëpërmjet Konsulentit, në çdo kohë dhe herë pas here, me kërkesë të Bankës, nënshkruan dhe paraqet çdo dokument tjetër apo kryen veprime të tjera që Banka mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme, me qëllim që të provojë, të përmbushë ose t'i japë fuqi të plotë ligjore termave, kushteve, synimit dhe kuptimit të kësaj Marrëveshjeje.

6.15 Koha me rëndësi të madhe

E pazbatueshme.

6.16 Kopjet origjinale të Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje mund të nënshkruhet në tri kopje origjinale, ku të gjitha së bashku përbëjnë një dhe të vetmen Marrëveshje.

6.17 Logoja e BERZH-it

Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Përfituesi janë vënë në dijeni që logoja e Bankës është një markë shërbimi e regjistruar dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Përfituesi, nuk e riprodhojnë logon pa lejen specifike me shkrim të Bankës.

Në dëshmi të kësaj, palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar rregullisht, kanë realizuar nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje në tri kopje në gjuhën angleze, në datën dhe vitin e shkruar më sipër.

Për dhe në emër të përfituesit
Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave

.....
Shkëlqim Cani
Ministër
Ministria e Financave
Datë:

Për dhe në emër të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
.....
Steven Gillard
Këshilltar i Lartë
Bashkëpunimi Teknik
Datë:

SHTOJCA A
FORMULARI I DEKLARIMIT TË APROVIMIT TË SHËRBIMEVE

SHTOJCË E MARRËVESHJES SË GRANTIT
FORMULARI I DEKLARATËS SË APROVIMIT TË SHËRBIMEVE TË KONSULENCËS

Të nënshkruhet nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe të dërgohet me faturën(at) për Shërbimet nga Konsulenti

Fatura nr. Data e faturës: Shuma e faturës:

Marrëveshje Granti nr. C29314/NONC-2010-12-04 OL: Raphael Rashid

1. Në pajtim me Kontratën e konsulencës për ndërtimin e kapacitetit për koncesionet për investimet në energji dhe industri (shërbimet), datë _____, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (Ministria e Energjisë dhe Industrisë) dhe _____ (Konsulenti); dhe në pajtim me klauzolën 2.02(d) të Marrëveshjes së Grantit për Shërbimet, datë _____, të lidhur ndërmjet Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka) dhe Përfituesit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë deklaron se:

i) Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka marrë dhe është e bindur për Shërbimet e Konsulentit që ishin kontraktuar në Kontratën e Konsulencës dhe që mbulohen nga faturat e bashkëlidhura;

ii) Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka verifikuar faturat dhe të gjitha dokumentet shoqëruese, të cilat lidhen me kryerjen e shërbimeve kundrejt shumave të përcaktuara në Kontratën e Konsulencës dhe është e bindur që:

a) fatura(t) është (janë) një përfaqësim i saktë i shërbimeve të dhëna nga Konsulenti; dhe

b) shuma(t) e caktuar(a) në faturë(at) përputhet(n) me shumën(at) e përcaktuar(a) në Kontratën e Konsulencës;

ii) fatura(t) dhe të gjitha dokumentet shoqëruese janë paraqitur së bashku me deklarinimin e aprovimit të ekipit të faturimit TC, Njësisë së Kontrollit të Faturave të Bankës për pagesë; dhe

iv) Ministria e Energjisë dhe Industrisë i ka paguar Konsulentit të gjitha taksat jo të drejtpërdrejta, duke përfshirë TVSH-në, në lidhje me faturat e mëparshme dhe merr përsipër të paguajë taksat jo të drejtpërdrejta, duke përfshirë TVSH-në, në lidhje me faturën(at) bashkëlidhur

brenda 30 ditëve nga data e këtij deklarimi aprovimi.

2. Ministria e Energjisë dhe Industrisë deklaron që nëpërmjet nënshkrimit të këtij dokumenti, Ministria e Energjisë dhe Industrisë autorizon Bankën të kryejë livrimin e rënë dakord në Kontratën e Konsulencës të Konsulentit në emër të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

Në dëshmi të kësaj, pala, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesit të saj të autorizuar, ka nënshkruar këtë deklaratë, më (datë).

PËR DHE NË EMËR TË

Ministër i Energjisë dhe Industrisë